

Thirrje për ofertë për përpunimin/krijimin dhe aksesueshmërinë e webfaqes së internetit

Krijimi i ndërfaqës së internetit për projektin **ACTIVE**, në kuadër të webfaqes ekzistuese të Caritas Kosova, sipas udhëzimeve të bashkëngjitura dhe rregullimi i aksesueshmërisë së faqes ekzistuese duke zgjedhur ofertuesin më të favorshëm për nevojat e projektit: *“ACTIVE - Komunikimi i aksesueshëm drejt përfshirjes së personave të cenueshëm dhe të përjashtuar në Ballkanin Perëndimor”*

FTESË PËR DORËZIM TË OFERTAVE

1. Përshkrimi i lëndës së prokurimit dhe specifikimet teknike

Krijimi i ndërfaqës së internetit për projektin **ACTIVE**, në kuadër të webfaqes ekzistuese të Caritas Kosova, sipas udhëzimeve të bashkëngjitura dhe rregullimi i aksesueshmërisë së faqes ekzistuese duke zgjedhur ofertuesin më të favorshëm për nevojat e projektit: *“ACTIVE - Komunikimi i aksesueshëm drejt përfshirjes së personave të cenueshëm dhe të përjashtuar në Ballkanin Perëndimor”*

Detyrat e mëposhtme duhet të zbatohen si në vijim:

DETYRA 1. Krijimi i një LINKU/BUTONI të ri www.aksueshmeria.com, në webfaqen ekzistuese, sipas udhëzimeve të dhëna në këtë: [LINK](#).

LINKU/BUTONI i ri, duhet të jetë i aksesueshëm dhe i lehtë për t'u përdorur, i pranueshëm dhe më i lehtë për t'u zotëruar nga një numër më i gjerë përdoruesish dhe për qëllim të publikimit të përditshëm të përmbajtjeve të reja tekstuale video dhe audio për të informuar publikun rreth aktiviteteve në projekt.

DETYRA 2. Analiza e webfaqes ekzistuese të Caritas Kosova dhe përshtatja e saj sipas udhëzimeve të dhëna në këtë: [LINK](#).

2. Afati i kryerjes së detyrave

Për Detyrën 1 dhe Detyrën 2: 30 ditë nga data e nënshkrimit të Kontratës. Orari i detajuar dhe dinamika do të përcaktohet pas nënshkrimit të Kontratës

3. Lloji i kontratës

- Personat juridik: Kontratë për shërbime (pagesë me faturë)
- Personat fizik: Kontrata e punës në bazë të kornizës ligjore

4. Afati i fundit i dorëzimit të ofertës

Deri më: 17.11.2023

Dërgoni ofertat tuaja me e-mail në: info@caritaskosova.org

Ofertat që nuk janë të plota ose arrijnë pas afatit nuk do të merren parasysh. Ekipi i projektit rezervon të drejtën të kontaktojë çdo ofertues për të verifikuar informacionin e paraqitur, duke përfshirë kontrollet administrative të ofertuesit dhe regjistrimin e tyre për aktivitetin në fjalë.

5. Mënyra e dorëzimit të ofertave, personi i kontaktit dhe adresa

Oferta duhet të përfshijë çmimin: për personat fizik - vlera neto, personat juridik - çmimin pa TVSH. Përveç kësaj, oferta duhet të përmbajë:

1. Ofertuesi – person juridik

- Certifikata e Regjistrimit (NUI), adresa, personi kontaktues

- Të paktën 3 referenca për të njëjtën punë, ose punë të ngjashme, të kryera në tre vitet e fundit me lidhje në faqet e internetit të zhvilluara nga ofertuesi, të cilat dëshmojnë se Ofertuesi ka përvojë në dizajnimin e webfaqeve dhe zbatimin e projekteve komplekse.

2. Ofertuesi – person fizik

- CV me informacione të rëndësishme për thirrjen
- Të paktën 3 referenca për të njëjtën punë, ose punë të ngjashme, të kryera në tre vitet e fundit me lidhje në faqet e internetit të zhvilluara nga ofertuesi, të cilat dëshmojnë se Ofertuesi ka përvojë në dizajnimin e webfaqeve dhe zbatimin e projekteve komplekse.

6. Kriteret e përzgjedhjes

Kriteri bazë për zgjedhjen e ofertuesit është raporti i cilësisë së shërbimit me çmimin e ofertës.

7. Konflikti i interesit

Ofertat nuk mund të paraqiten nga persona juridik ose fizik që janë në konflikt të mundshëm interesi, pra persona që mund të ndikojnë në çfarëdo mënyre në procesin e vendimmarrjes objektive. Komiteti dhe ekipi i projektit rezervojnë të drejtën për të refuzuar një aplikim që konstatohet se është në një konflikt të mundshëm interesi në përputhje me ligjet vendore.

Për çdo informacion shtesë, mund të kontaktoni në: info@caritaskosova.org